



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

VENDIM

Nr. 2 / Datë 19.04.2008

PER MIRATIMIN E PERKTHIMIT NE GJUHEN SHQIPE TE STANDARDEVE
NDERKOMBETARE TE KONTABILITETIT DHE TE RAPORTIMIT
FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 4, pikës 3, të Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 " Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672 datë 26.10.2005 "Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit", Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në mbledhjen e datës 18.04.2008, mbas diskutimit të materialit të paraqitur nga Grupi i punës, i ngritur për të rishikuar materialet e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, si dhe të komentareve të tyre, të përkthyer në gjuhën shqipe nga kompania angleze IMCL.

VENDOSI:

1. Aprovimin e materialit përfundimtar të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Raportimit Financiar (SNRF), si dhe të komentareve të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe, nga kompania angleze IMCL.
2. Materialet përfundimtare të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar (SNK, SNRF), si dhe komentaret e tyre, të përkthyer në gjuhën shqipe nga kompania angleze IMCL, t'i paraqiten Ministrit të Financave për t'i shpallur për zbatim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Jorgji BOLLANO

